ORTIVA TOP 20/12.5 SC

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE





KUJDES

"Lexo fletudhëzuesin para përdorimit"

Fungicid sistemik me veprim parambrojtës dhe shërues, për kontrollin e sëmundjeve të ndryshme kërpudhore. Azoxystrobina i përket grupit strobilurin, ka veprim specifik (kontakti dhe pjesërisht translaminar) dhe që pengon mbirjen e sporeve, rritjen e micelit dhe prodhimin e sporeve, duke kontrolluar një gamë të gjerë të kërpudhave. Në nivelin biokimik, veprimi i tij është në kompleksin III të zinxhirit të frymëmarrjes. Difenoconazole është një fungicid sistemik, që i përket grupit triazol, dhe është efektiv në një gamë të gjerë të kërpudhave patogjene. Në nivelin biokimik, veprimi i tij konsiston në parandalimin e demetilimit të C_{14} gjatë procesit të biosintezës së ergosterolit. Aplikohet me spërkatje gjethore parambrojtëse ose me shfaqjen e shënjave të para.

Lëndët vepruese: *20% Azoxystrobin+12,5% difenoconazole*
Formulimi: *Koncentrat i suspendueshëm (SC).*

Masa parambrojtëse:

- Të ruhet në vende të sigurta dhe larg fëmijëve.
- Shmangni thithjen e pluhurit/tymit/gazrave/pikave e avujve të tretësirës spërkatëse.
- Mos hani e mos pini lëngje ose duhan gjatë përdorimit.
- Vishni doreza mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mjete mbrojtëse personale për mbrojtjen e syve dhe fytyrës.
- Gjatë trajtimit vishni uniformë dhe doreza të përshtatshme mbrojtëse. Vishni gjithashtu mjetet për mbrojtjen e syve/fytyrës dhe mjetet mbrojtëse personale për mbrojtjen mbrojtjen rrugëve e frymëmarrjes gjatë përzierjes/transportit.
- Në rast të ri-hyrjes pas spërkatjes, punëtorët duhet të veshin doreza, këmishë me mëngë të gjata dhe pantallona të gjata.
- Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe për mjedisin, ndiqni me kujdes udhëzimet e përdorimit.
- Menaxhoni përmbajtjen/ambalazhin në përputhje me ligjeslacionin kombëtar ne fuqi.

Udhezime për ndihmën e parë dhe këshilla për mjekun:

- Në rast aksidenti, kërkoni menjëherë këshillë mjekësore dhe i tregoni mjekut ambalazhin ose etiketën.
- I dëmshëm nëse gëlltitet. *Në rast gëlltitje:* Thirrni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun, nëse nuk ndjeheni mirë.
- Në rast kontakti me sytë: Shpëlajini menjëherë me ujë të bollshëm për disa minuta dhe kërkoni këshilla mjekësore. Hiqni lentet e kontaktit.
- Mund të shkaktojë reaksion alergjik të lëkurës. Përmban 1,2-bensizothiazol-3 (2H) -one. *Në rast kontakti me lëkurën:* Lajeni me ujë të bollshëm dhe sapun. Nëse shfaqet acarim ose skuqje e lëkurës: Këshillohuni/vizitoni me një mjek. Hiqni rrobat e ndotura dhe i lani para se ti ripërdorni.
- I dëmshëm nëse mirret me organët e frymëmarrjes. *Në rast se merret me organet e frymëmarrjes:* Nxireni të aksidentuarin në ajër të pastër dhe lëreni të pushojnë në një pozicion që lehtëson frymëmarrjen. Thirrni menjëherë Qendrën e Helmimeve ose mjekun, nëse nuk ndjeheni mirë.
- *Antidoti:* Antidot specifik nuk njihet. Ndiqni trajtim simptomatik.

Përdorimi:

Lule lakër: për kontrollin e alternariozës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-600 lit/ha. Nga faza e formimit të kokës deri në shfaqjen e luleve të para të mbyllura (BBCH 40-55). Deri në 2 trajtime çdo 14 ditë.

Lakër: për kontrollin e alternariozës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-600 lit/ha. Nga faza e fillimit të formimit të kokës deri sa ato të kenë arritur madhësinë dhe formën tipike (BBCH 40-49). Deri në 2 trajtime çdo 14 ditë.

Brokol: për kontrollin e alternariozës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-600 lit/ha. Nga faza e fillimit të formimit të kokave deri në shfaqjen e luleve të para të mbyllura (BBCH 40-55). Deri në 2 trajtime çdo 12 ditë.

Selino: për kontrollin e alternaries, septoriozës, hirit: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-1000 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të gjethit deri sa të arrije në 80% të madhësisë dhe formës së tij tipike (BBCH 40-48). Deri në 3 trajtime çdo 14 ditë.

Karotë: për kontrollin e alternaries, septoriozës, hirit: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-1000 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të frutrrënjorit (diametri > 0.5 cm) deri sa të arrij madhësinë dhe formën e tij tipike (BBCH 40-49). Deri në 3 trajtime çdo 14 ditë.

Pastinaca sativa (F): për kontrollin e alternaries: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-600 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të frutrrënjorit (diametri > 0.5 cm) deri sa të arrije madhësinë dhe formën e tij tipike (BBCH 40-49). Deri në 3 trajtime çdo 14 ditë.

Finok: për kontrollin e septoriozës, alternaries: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-1000 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të gjethit deri sa të arrij në 80% të madhësisë dhe formës së tij tipike (BBCH 40-48). Deri në 2 trajtime çdo 10 ditë.

Kastravec (F), kungull (F): për kontrollin e hirit, kladosporozës: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit uë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1500 lit/ha. Nga fillimi i formimit të frutit të 1^{rë} deri në pjekjen e plotë të frutave (BBCH 51-89). Deri në 3 trajtime çdo 10 ditë.

Pjepër (F/S), shalqi (F/S): për kontrollin e hirit, kladosporiozës: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degë së parë anësore deri në pjekjen e plotë të frutave (BBCH 21-89). Deri në 3 trajtime çdo 8 ditë.

Domate (F): për kontrollin e alternariozës, hirit, njollosjes kafe të gjetheve: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degës së parë anësore deri sa 70 % e frutave të marrin ngjyrën e tyre-pjekje (BBCH 20-87). Deri në 3 trajtime çdo 7 ditë.

Domate (S), patlixhan (S): për kontrollin e hirit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degës së parë anësore deri sa 70 % e frutave të marrin ngjyrën e tyre-pjekje (BBCH 20-87). Deri në 3 trajtime çdo 8 ditë.

Patlixhan (F): për kontrollin e alternariozës, hirit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degës së parë anësore deri sa 70 % e frutave të marrin ngjyrën e tyre-pjekje (BBCH 20-87). Deri në 3 trajtime çdo 7 ditë.

Spec (F): për kontrollin e alternariozës, hirit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degës së parë anësore deri sa 70 % e frutave të marrin ngjyrën e tyre-pjekje (BBCH 20-87). Deri në 3 trajtime çdo 10 ditë.

Spec (S): për kontrollin e hirit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Nga dalja e degës së parë anësore deri sa 70 % e frutave të marrin ngjyrën e tyre-pjekje (BBCH 20-87). Deri në 2 trajtime çdo 10 ditë.

Presh (F): për kontrollin e alternariozës, ndryshkut: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1000 lit/ha. Që nga nxjerja në masë të gjetheve, deri sa kërcelli të arrij diametrin dhe gjatësinë e tij standarde (BBCH 40-49). Deri në 2 trajtime çdo 14 ditë.

Qepë e njomë, hudhër: për kontrollin e alternariozës, ndryshkut: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-600 litra/ha. Që nga nxjerja në masë të gjetheve, deri sa bulbi të arrij në 50 % të madhësisë përfundimtare (BBCH 40-45). Një (1) trajtim.

Asparag: për kontrollin e ndryshkut: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1000 lit/ha. Kur dega më e gjatë ndalon të rritet deri sa pjesa e mbitokësore të plaket (BBCH 41-89). Deri në 2 trajtime çdo 14 ditë.

Bizele: për kontrollin e *Ascochyta pisi*: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1000 lit/ha. Nga shfaqja e petlave (lulet ende të mbyllura) deri sa 70% e bishtajave kanë arritur madhësinë e tyre standarde (nga shtypja del lëng) (BBCH 59-77). Deri në 2 trajtime çdo 14 ditë.

Majdanoz (F): për kontrollin e alternaries, septoriozës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1200 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të gjethieve deri sa të arrijnë madhësinë dhe formën e tyre standarde (BBCH 40-49). Deri në 2 trajtime çdo 7 ditë.

Marule (F): për kontrollin e alternaries, cerkosporës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1200 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të gjethieve deri sa të arrijnë madhësinë dhe formën e tyre standarde (BBCH 40-49). Deri në 2 trajtime çdo 7 ditë.
Cikore (F), Endivie (F), Spinaq (F), Rukol (F): për kontrollin e cerkosporës: 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1200 lit/ha. Nga fillimi i zhvillimit të gjetheve deri sa të arrijnë madhësinë dhe formën e tyre standarde (BBCH 40-49). Deri në 2 trajtime çdo 7 ditë.
Angjinar: për kontrollin e hirit: 1 litër/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 300-1000 lit/ha. Nga mbulimi i plotë i tokës nga gjethet deri në shfaqjen e lulërisë (kokës) (BBCH 40-55). Deri në 3 trajtime çdo 10 ditë.
Lule shtrydhe (S): për kontrollin e hirit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500-1000 lit/ha. Spërkatje gjethore parambrojtëse ose me shfaqjen e shënjave të para. Nga fillimi i formimit të stolonave (gjatësia > 2 cm) deri në vjeljen e dytë ku shumica e frutave kanë marrë ngjyrën standarde (BBCH 40-89). Deri në 2 trajtime çdo 7 ditë.
Lule dielli: për kontrollin e *Diaporthe helianthi:* 1 lit/ha. Sasia e tretësirës spërkatëse: 200-600 lit/ha. Nga shfaqja e lulerive deri në ndarjen e tyre nga gjethet e reja (BBCH 51-55). Një trajtim.
Ulliri (për tavolinë dhe për vaj): për kontrollin e syrit të palloit: 1 lit/ha ose 100 ml/100 lit ujë. Sasia e tretësirës spërkatëse: 500- 1000 lit/ha. Nga fillimi i rritjes së gjetheve të reja deri para-lulëzimit (BBCH 11-59). Një trajtim.

Fitotoksiciteti:
Nuk është fitotoksik kur përdoret në dozat dhe në kulturat e rekomanduara. Në varietetet e pjeprit (Hugo, Deneb) dhe domate (Saladar), është vërejtur një ndjeshmëri, e cila nuk pengoi rritjen ose prodhimin. Rekomandohet një provë e vogël para trajtimit të gjthë sipërfaqës në kulturën e domates dhe të pjeprit. Në disa varietete të mollës është fitotoksik. Prandaj gjatë trajtimit në fushat ngjitur me pemët e mollës duhet të tregohet kujdes që të evitohet shpërndarja e tretësirës spërkatëse në to. Mjetet spërkatëse që ishim përdorur për trajtim me ORTIVA TOP duhet të shpëlahen me kujdes të veçantë përpara se të përdoren tek molla.

Vërejtje për përdorimin:
Të mos përdoret në farishtet. Të mos trajtohet gjatë periudhave me lagështi të lartë ose në kombinim me hormonet e rritjes.
Menaxhimi i rezistencës: Përdorni në trajtimet parambrojtëse ose në fazat e hershme të zhvillimit të sëmundjeve dhe shmangni trajtimet shëruese; në programe trajtimesh, ne alternim me fungicide të grupeve të tjera me mënyrë të ndryshme të veprimit nga QoIs (strobilurinat) dhe DMI (triazolet), me të cilat nuk shfaqet rezistencë e kryqëzuar.

Ndikimi në mjedis:
Shumë toksik për organizmat ujorë, me efekte afatgjata. Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij. Mos i lani pajisjet e spërkatjes pranë ujrave sipërfaqësore.
Për të mbrojtur organizmat ujore lini një zonë të pa trajtuar prej 10-12 m nga ujrat sipërfaqësore për hurdhën, qepën e njomë, karotën , pastinaca sativa, bizeles dhe luleshtrydhes.
Për të mbrojtur organizmat ujore lini një zonë të pa trajtuar prej 18-20 m nga ujrat sipërfaqësore për kulturat e familjeve solanaceae, curcubitaceae, brassicaceae; angjinarit, asparagut, preshit, selinos, finokut, majdanozit, marules, çikores, endivies, spinaqit dhe të rukoles.
Për të mbrojtur organizmat ujore lini një zonë të pa trajtuar prej 5 m nga ujrat sipërfaqësore ose të përdorni sprucatorë që ulin 50 % krijimin e mjegullës spërkatëse për luledielin.
Për të mbrojtur organizmat ujore lini një zonë të pa trajtuar prej 20 m nga ujrat sipërfaqësore ose lini një zonë të pa trajtuar prej 10 m dhe përdorni sprucatorë që ulin 75 % krijimin e mjegullës spërkatëse për ullirin.

Karenca:
Trajtimi i fundit para vjeljes: Domate (fushe-F), patlixhan (F), angjinar, qepë e njomë: 7 ditë; Domate (sere-S), patlixhan (S), angjinar, spec (S/F), kastravec (F), kungull (F), pjepër (F/S), shalqi (F/S), lule shtrydhe (S): 3 ditë; karotë, pastinaca sativa, lule lakër, brokol, majdanoz (F), hudhër, selino, finok, bizele, Marule (F), cikore (F), endivie (F), spinaq (F), rukol (FH): 14 ditë; Lakër, presh: 21 ditë.
Periudha e sigurisë midis trajtimit dhe: - mbjelljes me farë ose fidan të kulturës bujqësore që do mbrohet: 3 javë nga mbjellja me farë ose fidan e kulturës bujqësore që do mbrohet.

- mbjelljes me farë ose fidan të kulturave pasardhëse: 30 ditë para mbjelljes me farë ose fidan të kulturave pasardhëse; - rifutjes së njerëzve ose të kafshëve në zonën e trajtuar: Deri sa të thahet tretësira e spërkatjes në sipërfaqen e gjetheve.

Kushtet e ruajtjes:
Ruhet në paketimin e tij origjinal, në një vend të freskët, të thatë, e të ajrosur mirë dhe larg rrezeve direkte te diellit. Të mos ruhet në temperatura mbi 40^0 C.

Nr dhe data e regjistrimit: 733, datë 24.4.2020;
Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin bazë: deri 1 Lit.
Data e prodhimit: *Printuar nga makineria në ambalazh*;
Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkesave të përcaktuara): 3 vite;
Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese: *Printuar nga makineria në ambalazh*;
Tipi i amballazhit bazë: shishe COEX ose HDPE.
Aplikanti: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Svicer.
Fabrikuesi i PMB-së: Syngenta Crop Protection AG. **Adresa:** Bazel, Svicer.